



e Rahovecit

1,000,000.00 € për vazhdimin e fazës së dytë të projektit kryesor për ndërtimin dhe funksionalizimin e Zonës Ekonomike

Komuna e Rahovecit, bashkë me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nënshkruan marrëveshjen për vazhdimin e financimit të fazës së dytë të projektit kryesor për ndërtimin dhe funksionalizimin e Zonës Ekonomike - Parku Industrial në Opterushë, i cili është bashkëfinancim i MINT-it dhe i Komunës së Rahovecit. Në këtë fazë do të investohen edhe 1,000,000.00€, mjete që do të sigurohen nga MINT-i.



U përrua fusha sportive në Gur të Kuq

Në hapësirën e ShFMU "31 Marsi" në Gur të Kuq, Komuna e Rahovecit përrua mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejbol, që do t'u shërbejnë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit për sport e rekreacion. Vlera e këtij investimi është: 33,394.00 €



Përrurohen 5 segmente rrugore me kubëza në Gur të Kuq

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës publike, sot, bëmë përrurimin e 5 segmenteve rrugore në fshatin Gur i Kuq, në gjatësi prej 975 metra.



Nënskruhet marrëveshja për grantin e performancës

Me grantin e performancës do të financohen këto projekte:

1. Ndërtimi i rrugëve në qytet: Rr. "Ibrahim Rugova", Rr. "Xhelal Hajda", Rr. "Rifat Dina", në vlerë prej 424,372.39€.
2. Ndërtimi i kolektorit dhe i shtratit të lumit Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac deri në Krushë të Madhe, në vlerë prej 592,373.40€
3. Fushat sportive dhe parqet, në: Nagac, Xërxë, Rahovec, Pataqan i Poshtëm, në vlerë prej 190,000.00€.
4. Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Sapniq, në vlerë prej 200,000.00€.
5. Ndërtimi i kanalit të kullimit të tokave bujqësore Fortesë - Celinë (faza II), në vlerë prej 208,000.00€.
6. Ndërtimi i shtandeve (tezga) mobile për mbajtjen e panaireve, në vlerë prej 30,000.00€.



Largohen deponitë ilegale të mbeturinave

Në "Rrezet" e Krushës së Madhe dhe te varrezat e dëshmorëve në Fortesë, është bërë pastrimi i mbeturinave të forta në deponitë ilegale



MARSI – muaji i përkujtimeve të masakrave të bëra nga serbët në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit përkujtoi më të dashurit e rënë nga serbët në marsin e vitit 1999.

Në 25-vjetorin e tyre, me tubime përkujtimore, bijat e bijtë e tyre, kujtuan:

25 Mars – fshatrat: Brestoc, Fortesë, Celinë;

26 Mars – Krusha e Madhe;

30 Mars – fshatrat: Retijë, Opterushë;

31 Mars – Pastaseli.



Në 25-vjetorin, përurohet Muzeu i Masakrës së Krushës së Madhe

Projekti i ndërtimit të muzeut është financuar nga Komuna e Rahovecit dhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Muzeu po pasurohet me artefakte të mbledhura nga qytetarët e Krushës, që do të shërbejë si dëshmi e tmerrit dhe e barbarisë serbe në këtë fshat.

Muzeu i Masakrës do të mbetet përgjithmonë simbol i fuqishëm i kujtesës sonë kombëtare.

